

Psalmi i Krijimit

1.

Prej qiejve përball Teje , ndriçim dhe madhështi,
Prej pafundësis së paanë dhe të voglës pafundësi,
Prej kupës qiellore, pelerina Jote e yjësuar,
Dhe prej Diellit vëlla... *Refreni*

REFRENI

Dua të bërtas Zoti im ! Ti je i madhë,
Ti je i mirë, Zot i gjallë, Zot i lartë,
Ti je Zot i dashurisë ! Zoti im, ti je i madhë,
Ti je i mirë, Zot i gjallë, Zot i lartë, Zot i pranishëm në çdo krijim.

2.

Prej gjithë oqeanëve dhe prej gjithë detëve,
Prej gjithë kontinenteve dhe ujit të lumenjve,
Prej zjarrit që të flet si një shkurre në përvëlím,
Prej flatrës së erës... *Refreni*

3.

Prej gjithë maleve dhe gjithë luginave,
Prej hijes së pyjeve dhe luleve nëpër fusha,
Prej sytheve të pemëve dhe bimëve në lëndina,
Prej kallzës së grurit... *Refreni*

4.

Prej gjithë kafshëve të tokës dhe ujit,
Prej këngës së zogjve, prej këngës së jetës,
Prej njeriut që ti krijove pak më të vogël nga Ty,
Dhe prej dithë fëmijëve... *Refreni*

5.

Prej kësaj dore të shtrirë që të fton në vallëzim,
Prej puthjes së rëmbyer nga vrulli i shpresës,
Prej vështrimit të dashuris që përçon dhe ngroh,
Prej bukës dhe verës... *Refreni*